



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-143/1

Në bazë të neneve 15.1 dhe 15.2.15 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe nenit 43.4 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 17 dhjetor 2020 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Plani i punës dhe performancës i AKP-së për vitin 2021.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Në mbledhjen e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të mbajtur me 17 dhjetor 2020, mbledhje urgjente, Bordi aprovoi sipas propozimit të Menaxhmentit Planin e punës dhe performancës të AKP-së për vitin 2021. Ky plan aprovohet në pajtim me nenet 15.1 dhe 15.2.15 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe nenit 43.4 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura. Bordi shqyrtoi raportin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 17/12/2020



Bajram Zejnullahu


Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit